



NJOFTIM PËR KONTRATË

Kontratë Furnizimi Procedurë e hapur

Në përputhje me nenin 10, "Procedura e hapur" të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

Data e shpalljes: 17.07.2026

Nr. i Prokurimit: "BQK 26 061 111"

I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK	
Adresa: Rr. "Luan Haradinaj" nr.2, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: +383 38 222 055/451	

II LËNDA E KONTRATËS

II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizimi dhe implementimi i projektit për menaxhim të qasjes së centralizuar në sistemet e TI-së"
Lloji i prokurimit: Kontratë furnizimi
Vendi kryesor i realizimit: Prishtinë
Informacione të marrëveshje afatgjatë: n/a
Variantet pranohen: Jo
Lloji i procedurës: Procedurë e hapur
Vlera e parashikuar e kontratës: 112,000.00 Euro
Ndarja në Pjesë: JO

III INFORMACIONE PËR SHERBIMIN

Qëllimi i kësaj kontrate është furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e Platformës për Menaxhimin e Qasjes dhe Identiteteve (Identity and Access Management – IAM), në përputhje me kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit

IV KRITERET E PËRZGJEDHJES¹/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim. **Vëmendje për operatorët ekonomik që t'i kenë parasysh kërkesat sipas tabelës në vijim rreth vendosjes së evidencave/dëshmime në ofertat e tyre.**

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 kur aplikohet) janë të obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i>	<u>Kërkesa 1:</u> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë. <u>Evidenca 1:</u> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në Aneksin përkatës i cili gjendet në dosjen e tenderit.
	<u>Kërkesa 2:</u> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C. <u>Evidenca 2:</u> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në Kërkesat 1, 2 dhe 3 të kësaj tablele.
	<u>Kërkesa 3:</u> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium) <u>Evidenca 3:</u> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, tenderi duhet të përmbajë një deklaratë të nënshkruar nga secili prej anëtarëve të grupit, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtën procedurë tenderimi. Në rast se një anëtar i një grupi tenderues merr pjesë në dy apo më tepër grupe për të njëjtin tender, secili nga grupet përkatëse ku është i përfshirë ky anëtar do të konsiderohet i papërgjegjshëm dhe përjashtohen si të tilla. Të gjithë anëtarët e grupit ose konzorciumit do të jenë së

¹ Sipas nenit 27 të Rregullës së prokurimit në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

	bashku dhe secili veçmas përgjegjës para Bankës Qendrore për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i jepet grupit në fjalë, ata gjithashtu do të jenë së bashku dhe veçmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit sipas nenit 31 të Rregullës për Prokurimin në BQK. Kurse kërkesat për kriteret e përzgjedhjes që kanë të bëjnë me kapacitetin ekonomik, financiar, teknik e profesional, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të konzorciumit.
<i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë e profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime</i>	<u>Kërkesa 4:</u> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. <u>Evidenca 4:</u> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. <u>Kërkesa 5:</u> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit. <u>Evidenca 5:</u> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin. <u>Kërkesa 6:</u> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata. <u>Evidenca 6:</u> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
	Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6 të kësaj tablele.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	Nuk aplikohen
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të	<u>Kërkesa 7:</u> Ofertuesi duhet të dëshmojë se gjatë tri (3) viteve të fundit (2023, 2024, 2025 dhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) ka realizuar me sukses së paku dy (2) kontrata që kanë për objekt furnizimin, implementimin dhe konfigurimin e platformave për Identity and Access Management (IAM) ose Identity Governance and Administration (IGA). <u>Evidenca 7:</u> Ofertuesi duhet të ofrojë si dëshmi: a) referencat ose certifikatat përkatëse që evidentojnë realizimin e

dokumenteve (kërkesat 7, 8, 9, 10 dhe 11) mund të kërkojnë dokumentacion plotësues ose sqarime	shërbimit të tillë dhe b) kopjet e kontratave përkatëse. <u>Kërkesa 8:</u> Ofertuesi duhet ta plotësoj formularin standard për kontratat e ngjashme që ofrohet në Dosjen e tenderit. <u>Evidenca 8:</u> Formulari i plotësuar dhe nënshkruar/vulosur me informatat për furnizimet e ngjashme të realizuara në tri (3) vitet e fundit (2023 dhe 2024, 2025 përfshirë edhe 2026 deri në shpalljen e këtij njoftimi për kontratë) duke saktësuar furnizimet e realizuara, shumen e kontratës, datën dhe pranuesin si dëshmi për secilën prej shërbimeve. <u>Kërkesa 9:</u> Ofertuesi duhet të jetë partner i autorizuar ose të ketë autorizim nga prodhuesi i zgjidhjes së propozuar për shitje, implementim dhe mirëmbajtje. <u>Evidenca 9</u> Autorizim nga prodhuesi (Manufacturer Authorization Letter), certifikatë partneriteti ose dokument ekuivalent i lëshuar nga prodhuesi që dëshmon të drejtën e ofertuesit për shitje, implementim dhe mirëmbajtje të zgjidhjes së propozuar. <u>Kërkesa 10:</u> Ofertuesi duhet të ketë ekip profesional për implementimin e projektit, i cili duhet të përfshijë së paku: • një (1) Menaxher Projekti; • një (1) Arkitekt IAM ose IGA; • një (1) Specialist për Integritet të sistemeve <u>Evidenca 10:</u> Ofertuesi duhet të ofroj si dëshmi a) Kopjet e certifikatave profesionale relevante b) CV-të e eksperteve c) Kopjet e kontratave të punës ose dëshmi të tjera që vërtetojnë angazhimin e tyre me ofertuesin. <u>Kërkesa 11:</u> Ofertuesi duhet të sigurojë BQK-në se ekipi i propozuar i punëtorëve do ta përcjell implementimin e kontratës deri në fund dhe se dhe se për çdo ndryshim eventual do të kërkojë miratim paraprak nga Banka Qendrore vetëm me staf ekuivalent. <u>Evidenca 11:</u> Dëshmi e deklaratës me shkrim (e nënshkruar dhe vulosur) nga ofertuesi si zotim për përmbushjen e kësaj kërkesë.
---	---

V PROCEDURA:

V.1 Lloji i procedurës: “Procedurë e hapur”, sipas *Nenit 10 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)*.

VI KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS:

“Tenderi i përshtatshëm me çmimin më të ulët”, në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK.

VII INFORMATA ADMINISTRATIVE PËR OFERTUESIT

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 03.08.2026, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 03.08.2026, ora 12:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org .
Afati i fundit dhe vendi i dorëzimit të ofertave, data: 05.08.2026, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave, data: 05.08.2026, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Luan Haradinaj” nr.2, Prishtinë.
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): 4,000.00 € (katër mijë euro) me vlefshmëri prej 90 ditësh nga data e hapjes së ofertave (dorëzohet me oferte)
Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.
Periodha e vlefshmërisë së ofertës: 90 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes së ofertës.
Dokumentet me pagesë: Jo

VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org , brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.
--

IX. ADRESA

Rr. "Luan Haradinaj" 2	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763